



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 148, datë 20.11.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 53, DATË 25.06.2009
“PËR TRAJTIMIN E DËMEVE QË MBULOHEN NGA KONTRATA E SIGURIMIT TË
DETYRUESHËM NË SEKTORIN E TRANSPORTIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 13, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.2.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” i ndryshuar, si dhe nenit 128, të Kodit të Procedurës Administrative, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", sipas tekstit bashkëngjitur.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI

Ndryshimet në Rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit":

1. Në kreun 2, Neni 4, pika 3, shtohet nënpika c si më poshtë:

"Të raportojë në regjistrin elektronik të dëmeve sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren nr. 36, datë 30.04.2009 "Për regjistrin elektronik të dëmeve të sigurimeve të detyrueshme motorike" brenda 1 dite pune nga momenti i hapjes së dosjes së dëmit."

2. Në Kreun 2, Neni 4, pika 5/c, fjalia ndryshon si më poshtë:

"Elementët e identifikimit të shkaktarit të dëmit (ID, emër, mbiemër, adresa, nr. tel., elementët e policës së sigurimit, përfshirë dhe një kopje e saj), në rast se shkaktari është pronari i mjetit të transportit."

3. Në Kreun 2, Neni 4, pika 5, shtohet nënpika d si më poshtë:

"Elementët e identifikimit të pronarit të mjetit shkaktar të dëmit (ID, emër, mbiemër, adresa, nr. tel., elementët e policës së sigurimit, përfshirë dhe një kopje e saj) në rast se shkaktari është drejtues i ndryshëm nga pronari i mjetit të transportit."

4. Në Kreun 2, Neni 4, shtohet pika 6, si më poshtë:

"Shoqëritë e sigurimit gjatë administrimit të të dhënave personale të subjekteve zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale.""